



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:069408

Datë: 24.01.2025

Numri i dokumentit: 06752224

KPPP.nr.426/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Business Center PAP” L.L.C., me NUI: 810971003, me seli në Prizren, përfaqësuar sipas autorizimit nga Alija Ajro, avokat nga Prizreni, kundër debitorit “MoEnja” SH.P.K., me NUI: 811563586, me seli në Prizren, rruga “Besim Shala”, përfaqësuar sipas autorizimit nga Fisnik Sogojeva, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorëve të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.304/2024, të datës 08.02.2024, të Përmbartuesit Privat Enis Hoxha, me seli në Prizren, jashtë seancës me datën 24.01.2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “MoEnja” SH.P.K., i paraqitur kundër urdhrit përmbartimor P.nr.304/2024, të datës 08.02.2024, të Përmbartuesit Privat Enis Hoxha.
- II. MBETET NË FUQI urdhri përmbartimor P.nr.304/2024, i datës 08.02.2024, i Përmbartuesit Privat Enis Hoxha.
- III. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim t’ia paguaj kreditorit shumën prej 104.00 € (njëqind e katër euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Business Center PAP” L.L.C., ka nxjerrë urdhrin P.nr.304/2024, të datës 08.02.2024, në bazë të dokumentit përmbartues

Kontratës mbi Qiranë e Paluajtshmerisë - LRP-nr. rend 2720/2023, Ref.nr.539/2023 të datës 15.05.2023, përpiluar nga Noter Suna B. Sallahi, me të cilin ka caktuar zbatimin e përmbarimit ndaj debitorit “MoEnja” SH.P.K., dhe ka detyruar debitorin që në emër të borxhit t’ia paguaj kreditorit shumën prej 7,150.00 €, nga dita e pranimit të këtij urdhri, së bashku me shpenzimet e procedurës së përmbarimit, nën kërcënim të përmbarimit, në të kundërtën përmbarimi të realizohet me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë e përmbaruesit privat apo sekuestrimin, vlerësimin e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, deri në përmbushjen përfundimtare të borxhit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar se i njëjti është në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së. Tutje ka shtuar se në kontratën e cila është objekt i kësaj procedure përmbarimore mungon pëlqimi i debitorit lidhur me efektin përmbarimor të kontratës andaj nuk mund të konsiderohet se kontrata ka efekt përmbarimor. Ka theksuar se borxhi i paraqitur nga kreditori në propozim për përmbarim në shumë prej 7,150.00 €, nuk është borxhi real pasi që nuk dihet se si është kalkuluar kjo vlerë e borxhit, po ashtu përveç pagesës prej 1,000.00 € sipas urdhrorit 05/01 dhe 06/01, të cilën e ka pranuar kreditori me propozim për përmbarim, debitori me datë 04.10.2023 ka realizuar pagesë ndaj kreditorit në shumë prej 2,400.00 €, si dhe me datë 05.10.2023 ka realizuar pagesë në shumë prej 3,163.80 €, me çka rezulton se debitori e ka përmbushur në tërësi borxhin ndaj kreditorit. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri përmbarimor si dhe të detyrohet kreditori që debitorit t’ia kompensoj shpenzimet e përpilimit të prapësimin në shumë prej 156.00 €.

Kreditori përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim me të cilën e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit duke theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit se akti noterial i mungon pëlqimi i debitorit që akti noterial si dokument i përmbarueshëm të ketë efekt përmbarimor, pasi që debitori me rastin e nënshkrimit të kontratës ka pranuar që kontrata – akti noterial paraqet titull përmbarimor. Sa i përket pretendimit lidhur me pagesat e realizuara për periudhën 01.07.2023 – 31.12.2023, nuk qëndron një pretendim i tillë për faktin se pagesa në shumë prej 2,400.00 € e datës 04.10.2023 dhe pagesa në shumë prej 3,163.80 € e datës 05.10.2023, janë paguar si detyrim për lëndën sipas urdhrorit përmbarimor P.nr.243/2023 të datës 21.07.2023 në shumën e përgjithshme prej 5,563.80 €, ndërsa vetëm pagesa prej 1,000.00 € është pagesë për periudhën për të cilën është kërkuar me këtë propozim për përmbarim. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit, ndërsa

urdhrin përmbartimor ta lë në fuqi, si dhe të detyrohet debitori që kreditorit t'ia kompensoj shpenzimet për përpilimin e propozimit në shumë prej 156.00 € si dhe për përpilimin e përgjigjes në prapësim në shumë prej 156.00 €.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigja në prapësim si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Me nenin 21 të LPP-së përcaktohet se *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”* ndërsa me nenin 22, par.1, nën-par 1.3 të LPP-së përcaktohet se *“Dokumente përmbartuese janë: dokumenti noterial i përmbartueshëm në pajtim me ligjin për noterinë”*.

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbartimor Kontratën mbi Qiranë Paluajtshmërisë - LRP-nr. rend 2720/2023, Ref.nr.539/2023 të datës 15.05.2023, në bazë të së cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin dhe gjeti se i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbartues sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Sipas nenit 26 par. 1 të LPP është përcaktuar se: *“Dokumenti i noterizuar është i përmbartueshëm nëse është bërë i përmbartueshëm sipas rregullave të veçanta që rregullojnë përmbartueshmërin e atij dokumenti”*, ndërsa me nenin 32 të Ligjit nr. 03/L-10 për Noterinë e Kosovës në fuqi në kohën e përpilimit të dokumentit noterial përcaktohet se: *“Dokumenti i noterizuar dhe i përgatitur në përputhje me procedurat përkatëse është drejtpërdrejtë e zbatueshme, me kusht që të përfshijë dispozitat e vlefshme mandatore e të pajtuara nga palët, si dhe deklaratën e palës nga e cila kërkohet kryerja e veprimit të caktuar, me efektin që zbatimi i drejtpërdrejtë dhe i detyrueshëm i obligimit mund të bëhet në pajtim me dokumentin e noterizuar, kur të jetë mbushur afati i obligimit”*.

Gjykata gjeti se në rastin konkret dokumenti përmbartimor Kontrata mbi Qiranë e Paluajtshmërisë - LRP-nr. rend 2720/2023, Ref.nr.539/2023 e datës 15.05.2023, mbi bazën e të

cilit është lejuar përbarimi, paraqet dokument të përbarueshëm në pajtim me nenit 32 të Ligjit për Noterinë, pasi që i njëjti dokument përmban dispozitat e vlefshme mandatore të pajtuara nga palët për efektin përbarues të këtij vendimi, ashtu siç kërkohet sipas Ligjit për Noterinë.

Gjykata po ashtu gjeti se Kontrata mbi Qiranë e Paluajtshmërisë - LRP-nr. rend 2720/2023, Ref.nr.539/2023 të datës 15.05.2023, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që i njëjti përmban të dhënat për kreditorin dhe debitorin, objektin, shumën të cilën e ka obligim ta paguaj debitori dhe kohën e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit sipas të cilave i njëjti me datë 04.10.2023 ka realizuar pagesë ndaj kreditorit në shumë prej 2,400.00 €, si dhe me datë 05.10.2023 ka realizuar pagesë në shumë prej 3,163.80 €, nga çka rezulton se debitori e ka përmbushur në tërësi borxhin ndaj kreditorit, mirëpo gjeti se një pretendim i tillë është i pabazuar. Kjo për faktin se nga parashtrësja e dorëzuar në gjykatë lidhur me transferet e datës 04.10.2023 dhe 05.10.2023, nuk mund të vërtetohet se këto transfere janë realizuar me qëllim të përmbushjes së detyrimit të kreditorit sipas kësaj marrëveshje, sepse të njëjtat nuk mbajnë përshkrimin për transaksionet e kryera. Andaj gjykata vlerëson se këto transfere nuk mund të shërbejnë si dëshmi, mbi bazën e të cilave do të mund të vërtetohej se debitori ka përmbushur detyrimin e tij ndaj kreditorit.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përbarimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke i’u njohur shpenzimet e të autorizuarit të kreditorit për përpilimin e përgjigjes në prapësim dhe atë në shumën prej 104.00 € (njëqind e katër euro), siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifën e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 71 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.426/24, datë 24.01.2025

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.